



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE GJILAN - DEGA E GJYKATËS VITI

Numri i lëndës: 2019:277536

Datë: 06.11.2024

Numri i dokumentit: 06410228

C.nr. 600/2019

GJYKATA THEMELORE NË GJILAN DEGA NË VITI, departamenti i përgjithshëm - divizioni civil, Gjyqtari Nexhat Aliu, me bashkëpunëtoren profesionale Lumturije Fetahu Xhelili, në çështjen kontestimore të paditësit N.Q.nga fshati K., Komuna e Vitisë, të cilin me autorizim e përfaqëson M.A.avokatë me seli të zyrës në Viti kundër të paditurëve A.D.ish nga fshati K., K.Viti , S.L. ish nga fshati K., K.Viti , gjykata u ka caktuar përfaqësuesin e përkohshëm Shpëtim Bislimi , avokatë me seli të zyrës në Viti , të paditurit E.R.nga Ferizaji, S.S.nga fshati K., K.Viti dhe R.D. nga fshati K., K.Viti, me objekt kontesti vërtetimi i pronësis, vlera e kontestit 9,500.00€, pas mbajtjes së shqyrtimit gjyqësor, me datë 28.10.2024, me datë 31.10.2024, mori këtë:

A K T G J Y K I M

I APROVOHET si tërësisht e bazuar kërkesëpadia e paditësit N.Q.nga fshati K., Komuna e Vitisë dhe :

a) Vërtetohet se paditësit, në bazë të mbajtjes me mirëbesim, është pronar i ngastrave kadastrale me numër 01574-0, në vendin e quajtur “ Rajc Ristina ”, me sipërfaqe prej 1142m², ZK Viti, e cila tek DGJKP në Viti është e regjistruar sipas certifikatës me numër të lëndës 1284/2024 në emrin e A.D.ish nga K.i

b) Vërtetohet se paditësit, në bazë të mbajtjes me mirëbesim, është pronar i ngastrës me numër 01607-0, në vendin e quajtur “ Rajc Ristina ”, me sipërfaqe prej 280 m², ZK Viti, e cila tek DGJKP në Viti është e regjistruar sipas certifikatës me numër të lëndës 1284/2024 në emrin e A.D.ish nga K.i.

c) Vërtetohet se paditësit, në bazë të mbajtjes me mirëbesim, është pronar i ngastrës me numër 01563-0, në vendin e quajtur “ Rajc Ristina ”, me sipërfaqe prej 1703m², ZK Viti, e cila tek DGJKP në Viti është e regjistruar sipas certifikatës me numër të lëndës 1284/2024 në emrin e Sokoloviq Petar(Ljubomir) ish nga K.i.

ç) vërtetohet ndaj të paditurit E.R.nga Ferizaji, / *trashigimtar ligjor i të ndjerit R.R. në emër të të cilit evidentohet paluajtshmëria kontestuese/* se paditësi në bazë të marveshjes konsensuale mbi shitblerjen është pronar i ngastrave kadastrale me numer 01565-0 vendi quajtur “Rajac Plozh”, në sipërfaqe të përgjithshme prej 5227 m², dhe ngastres 01572-0, në vendin e quajtur “Rajac Ristina”, në sipërfaqe të përgjithshme prej 4645 m², ZK – Viti, të cilat tek DGJKP në Viti janë të regjistruara sipas certifikatës me numër të lëndës 1285/2024 në emrin e të ndjerit Ramadan (Rasim) Ramadani ish nga fshati K., K.Viti.

d) vërtetohet ndaj të paditurit S.S.nga fshati K., K.Viti , / *trashigimtar ligjor i të ndjerit Rrahim Selimi (Deli), në emër të të cilit evidentohet paluajtshmëria kontestuese*/ se paditësi në bazë të marveshjes konsensuale mbi shitblerjen është pronar i ngastres kadastrale me numer 01550-0 në sipërfaqe të përgjithshme prej 1148 m², e cila gjendet në vendin e quajtur “Rajac” ZK – Viti, e cilat tek DGJKP në Viti është e regjistruar sipas certifikatës me numër të lëndës 1298/2024 në emrin e të ndjerit Rrahim (Deli) Selimi ish nga fshati K., K.Viti.

e) vërtetohet ndaj të paditurit R.D.nga fshati K., K.Viti , / *trashigimtar ligjor në bazë të drejtës së perfaqsimi të ndjerit M.S., në emër të të cilit evidentohet paluajtshmëria kontestuese*/ se paditësi në bazë të marveshjes konsensuale mbi shitblerjen është pronar i ngastres kadastrale me numer 01549-0 në sipërfaqe të përgjithshme prej 1168 m², e cila gjendet në vendin e quajtur “Rajac pljozh” ZK – Viti, e cilat tek DGJKP në Viti është e regjistruar sipas certifikatës me numër të lëndës 1298/2024 në emrin e të ndjerit Metush Selimi (Deli), ish nga fshati K., K.Viti.

II.DETYROHEN të paditurit, A.D.ish nga fshati K., K.Viti , S.L.. ish nga fshati K., K.Viti , E.R.nga Ferizaji, S.S.nga fshati K., K.Viti dhe R.D. nga fshati K., K.Viti, t’ia njohë të drejtën e pronësisë paditësit N.Q.nga fshati K., Komuna e Vitisë dhe të durojë që ngastrat e lartpërmendur të regjistrohet në emrin e paditësit.

III. Ky aktgjykim për Drejtorinë për Kadastër, Pronë dhe Gjeodezi të Komunës së Vitisë, paraqet bazë, që në regjistrat kadastralë, të bëhet ndryshimi.

IV.Shpenzimet e procedurës do t’i heq paditësi.

V. KONSTATOHET E TËRHEQUR padia e paditësit N.Q.nga fshati K., Komuna e Vitisë, ndaj të paditurit Qoviq.R.RexhinR.I.Zh.V. ish nga fshati K., Komuna e Vitisë, me objekt të kontestit, vërtetimi i pronësisë.

A R S Y E T I M

Pretendimet e palëve ndërgjyqëse .

Paditësi, Z.Q.nga fshati K., Komuna e Vitisë, në këtë Gjykatë ka ushtruar padi kundër të paditurëve Q.R. (R.L.) Zh.V., A.D., S.P. dhe R.R.që të gjithë nga fshati K., Komuna e Vitisë, për vërtetimin e të drejtës së pronësisë në ngastrat kadastrale me 01573-0, e cila gjendet në vendin e quajtur “Rajc Ristina” ZK – Viti , në sipërfaqe të përgjithshme prej 1368m², dhe parcelën me numer 01606-0 e cila gjendet në vendin e quajtur “Rajcs Ristina” ZK – Viti , në sipërfaqe të përgjithshme prej 325m², të cilat parcela i ka blerë në muajin maj të vitin 1985 në shumë prej 28.000 dinar nga i padituri Q.R. R.I.Zh.V. . Po ashtu parcelen me numër 01574-0 e cila gjendet në vendin e quajtur “Rajc Ristina” ZK – Viti , në sipërfaqe të përgjithshme prej 1142m², të cilën parcela e ka blerë në muajin korrik të vitin 1987 në shumë prej 20.100 dinar nga i padituri A.D.. Parcelen me numër 01563-0 e cila gjendet në vendin e quajtur “Rajac Ristina” ZK – Viti , në sipërfaqe të përgjithshme prej 1703m², të cilën parcela e ka blerë në muajin dhjetor të vitin 1982 në shumë prej 15.200 dinar nga i padituri S.P.. Dhe parcelat me numër 01565-0 në sipërfaqe të përgjithshme prej 5227m² dhe parcelen me numer 01572-0 në sipërfaqe të përgjithshme prej 4645m², të cilat gjenden në vendin e quajtur “Rajac Plozh” ZK – Viti , të cilat parcela i ka blerë në muajin maj

të vitin 1980 nga i padituri R.R. Duke i marr për bazë të lartcekurat, gjykatës i ka propozuar aprovimin e kërkesëpadisë si tërësisht e bazuar, duke i kërkuar edhe shpenzimet procedural.

Meqenëse palës të paditura, nuk është arritur që t'i dorëzohet padia në mënyrë të rregullt, pasi në adresën ekzistuese sipas shkresave të lëndës-fletëkthesës, rezulton se adresa e tyre është e panjohur, gjykata ka kërkuar nga Stacioni Policor në Viti, sigurimin e adresës dhe vendbanimit të tyre.

Pasi që nga ana e Policisë së Kosovës, nuk ka qenë e mundur të sigurohet adresa e të paditurëve me kërkesën e përfaqësuesit të paditësit, gjykata, të paditurëve, në pajtim me nenin 79 pika 3 dhe 81 të LPK-së, i ka caktuar përfaqësues të përkohshëm nga radha e avokatëve, për të mbrojtur të drejtat e tyre, vendim ky i cili është publikuar në tabelën e shpalljeve të gjykatës dhe në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës, konform nenit 83 të LPK-së.

Gjykata, e ka nxjerrë aktvendimin për përgjigje në padi, me të cilin i ka detyruar të paditurit që në afat prej 15 ditësh, të paraqet përgjigje në padi, ti paraqesin prapësimet procedurale dhe të deklarojnë se a e pranojnë apo e kontestojnë kërkesëpadinë e paditësit.

Përfaqësuesi me autorizim i paditësi, av.M.A.me parashtresën e datën 12.09.2024, sipas aktvendimit procedural të séances përgaditore të dates 26.08.2024 të kësaj gjykata ka bërë rregullimin e padisë në aspektin subjektiv dhe objektiv . Ashtu që përmes kësaj parshtrese në vend të paditësit Z.Q.tani është si paditës N.Q.nga fshati K., Komuna e Vitisë.Tutje ka shtuar e tërheqë padinë e paditësit Q.R. R.I.Zh.V. ish nga fshati K., K.Viti dhe atë nga ngastrat kontestuese me nr.01573-0 sipërfaqe 1369m2, në vendin e quajtur „Rajc Ristina”, dhe ngastres me numër 01606-0 me sipërfaqe 325m2 në vendin e quajtur „Rajc Ristina, ZK-Viti.

I padituri i dytë A.D. ish nga fshati K. dhe ngastrat ngelen të njëjta si në padi, ngastra me nr.01574-0, në vendin e quajtur Rajc Ristina”, me sipërfaqe 1142 m2 ZK-Viti, ndërsa ka bërë zgjerimin e padisë në kuptimin objektiv, duke kërkuar që ti njihet paditësit edhe ngastra e re me numër 1607-0 në sipërfaqe 280 m2 në vendin e quajtur „Rajc Ristina”, ZK-Viti. Për të paditurin e tretë S.P. ngelen të njëjtat si në padi.

Ndërsa ka bërë ndryshimin e padisë në kuptimin subjektiv duke e tërhequr padinë nga i padituri i katër Ramadan Ramadani(Rasim)ish nga fshati K. tani i ndjerë, dhe në vend të këtij padituri tani i paditur do të jetë E.R.nga Ferizaji, djali i tij si trashigimtar i pare ligjor, për ngastrën me nr.01565-0 me sipërfaqe 5227m2 dhe ngastren 01572-0 me sipërfaqe 4645m2, në vendin e quajtur „Rajac Plozh”, ZK-Viti. Po ashtu ka bërë zgjerimin e padisë në kuptimin objektiv dhe subjektiv ku tani si të paditur do të jenë edhe S.S., nga fshati K., K.Viti lidhur me ngastren me nr.1550-0, ne sipërfaqe prej 1148m2 ne në vendin e quajtur „Rajac”, ZK-Viti, e cila ngaster figuron në emër të R.S.tani i ndjerë(baba i të paditurit S.S.).Pastaj si i paditur do të jetë edhe R.D., nga fshati K., K.Viti lidhur me ngastren me nr.1549-0, ne sipërfaqe prej 1168 m2 ne në vendin e quajtur „Rajac Pljozh”, ZK-Viti , e cila ngaster figure në emër të Metush Selimit tani i ndjerë(gjysh i të paditurit R.D.).

Ku sipas parashtresës i ka propozuar gjykatës që të lejojë ndryshimin e padisë konform nenin 257 par 1 të LPK-së, ashtu që tani e tutje si paditës të konsiderohet N.Q.nga fshati K., Komuna e Vitisë, të cilin e përfaqëson av.M.A.nga Vitia, kundër të paditurëve A.D. ish nga fshati K.,K.Viti, S.P. ish nga fshati K., K.Viti, E.R.nga Ferizaji, S.S.nga fshati K., K.Viti dhe R.D. nga fshati K., K.Viti.

Përfaqësuesi me autorizim i paditësit në seancen përgaditore të dates 03.10.2024 dhe 11.10.2024 ka deklaruar se: në këtë fazë të procedurës bënë ndryshimin e padisë ne aspekti subjektiv dhe objektiv si ne parashtresën e dates 12.09.2024, te dorëzuar ne Gjykatë ka kërkuar nga gjykata që paditësit N.Q.ti njihet e drejta e pronësisë në ngastrat kadastrale nr.1574-0 në sipërfaqe prej 1142 m2, dhe ngastren nr.1607-0 në sipërfaqe prej 280m2 ZK.Viti, ku i paditur është Andrejeviq Dejko Joze, ish nga fsh.K.. Po ashtu kërkonë njohjen e pronësisë në ngastren kadastrale nr.1563-0 në sipërfaqe prej 1703m2, ne emer te paditurit Sokoloviq Petar nga fsh.K., nga se keto ngastra paditësi i ka blere ne vitin 1987 dhe ne vitin 1980, me dinar Jugosllave i ka paguar në teresi dhe nga ajo periudhe ka hyre

ne posedim duke mos u penguar nga askush. Ka kërkuar që të ju njihet e drejta e pronësis në dy ngastra kadastrale nr.1565-0 ne vendin e qujtur “Rajace Pllozhe” në sipërfaqe të përgjithshme 5227m2 dhe ngastren nr.1572-0 në sipërfaqe prej 4645m2, ne vendin e qujtur “Rajace Ristina” ZK.Viti, keto ngastra janë të evidentuar në emer të babait të paditurit Enver –babait Ramadan Ramadan, të cilat i ka blere ne vitin 1980, ka hyre ne shfrytezim dhe posedimi duke e punuar nga ajo periudhe, pa u penguar nga asku.Kërkojnë nga Gjykata njohen e pronësisë në ngastren kadastrale me nr.1550-0 ne sipërfaqe prej 1148 m2, ZK.Viti, e regjistruar ne emer te Rrahim Selimi tani i ndjer babai i Shaqir Selimi si i paditur, ketë ngaster e ka blere ne vitin 1982 ka hyre ne posedim dhe shfrytezim duke punuar nga ajo periudhe pa u penguar nga askush.Kërkon që ti njihet e drejta e pronësis në ngastren nr.1549-0 në sipërfaqe prej 1168 m2, në vendin e qujtur “Rajac Ploq” kjo ne kataster evidentohet ne emer te Metush Selimi tani i ndjer i cili është gjyshi i te paditurit R.D., kete ngaster e kishte blere mixha Bislim Qerimi ne vitin 1980, sa ishte gjalle babai i te paditurit Ramadan-Vehbi Deliu, nga ajo periudhe ka hyre ne posedim faktik duke shfrytezuar pa kurfar pengese nga askush, pagesa eshte bere ne teresi.

I padituri S.S.në seancen përgaditore të dates 03.10.2024 ka deklaruar se: nuk e kundërshton padin e asë kërkesepadin e paditësit, nga se është e vërtete se babai i tij Rrahim Selimi ashtu siq shkruhet ne padi ja kishte shitur ngastren kadastrale nr.1550-0 ne sipërfaqe prej 1148m2, kete ngaster ja kishte shitur mixhes së paditësit Bislim Qerimi se ateher keta ishin në nje bashkësi familjare, mirpo pase ndarjes së bashksies familjare kjo ngaster sa kishte ndegjuar ju kishte ndarë N.Q.tani paditësit. Ka kërkuar nga gjykata që të ja njeh të drejten e pronësis tani paditesit Naim Qerimi. Po ashtu ka kërkuar nga gjykata qe seanca te tjera ti mbaj ne mungesen e tij, pasi nuk ka tjetër qka te deklarone përpos këto që i ka deklaruar në seance gjyqesore(përgaditor).

I padituri R.D. në seancen përgaditore të dates 03.10.2024 ka deklaruar se: është e vërtete se babai i tij Vehbi Deliu këtë ngaster para disa vite ja kishte shitur tani mixhes të paditesit Naim Qerimi-Bislim Qerimi, dhe se për kete ngaster i kan mar të gjitha të hollat në teresi dhe që nga ajo kohe paditesi ka hyre ne posedim te kësaj ngastre, mirpo pas ndarjes nga mixha i tij kjo ngaster i ka takuar N.Q.tani paditesit. Po ashtu ka kërkuar nga gjykata qe seanca te tjera ti mbaj ne mungesen e tij, pasi nuk ka tjetër qka te deklarone përpos këto që i ka deklaruar në seance gjyqesore(përgaditor).

I padituri E.R.në seancen përgaditore të dates 03.10.2024 ka deklaruar se : është e vërtete se keto ngastëra babai i tij Ramadan Ramadani ja kishte shitur Bislim Qerimi që është mixha i paditesit, mirpo pasë ndarjes së bashkësis familjare keto ngastra ka ndegjuar se i kan takuar paditesit N.Q., për keto ngastër kadastrale ju ishte bërë pagesa në tërësi, pagesa kishte qen me dinar Jugosllave, pasi se ishte e vetmja valut ne ate kohe. Po ashtu ka kërkuar nga gjykata qe seanca te tjera ti mbaj ne mungesen e tij, pasi nuk ka tjetër qka te deklarone përpos këto që i ka deklaruar në seance gjyqesore (përgaditor).

Edhe gjatë shqyrtimit gjyqësor, përfaqësuesi i paditësit ka deklaruar se mbesin në tërësi pranë padisë dhe kërkesëpadisë duke shtuar se me adminsitrimin e provave në këtë çështje kontestimore është vërtetuar fakti se paditësi është pronar juridik i ngastrave kadastrale të lartcekuar.

Në fjalën e tij përfundimtare, përfaqësuesi i paditësit ka deklaruar: Mbetet pran padise dhe kërkeses padisë dhe parashtreses të ushtruar në Gjykate me dt.12.09.2024, ashtu qe nga provat e administruar që gjenden ne shkresat e lëndes, dalja e gjykates në vendin e ngjarjes me ekspertin gjeodet ku jan bere identifikimi i të gjitha ngastrave po ashtu me te besueshme kërkesepadin e paditesite kan bere deshmia e dy deshmitareve te cilet jan ndegjuar ne seancen kryesore, po ashtu pohimi i kërkesepadise i tre te paditueve Enver Ramadani,S.S.dhe R.D., nga keto baza u vertetuar gjendja juridike dhe baza juridike e kërkesepadise. Andaj nga keto arsye kerkon nga Gjykata që paditesit Naim Qerimit ti njihet e drejta e pronësisë në keto ngastra nr.1574-0 sipërfaqe prej 1142m2, nr.1607-0 sipërfaqe prej 280m2,

ngstren nr.1563-0 sipërfaqe prej 1703m², ngastren nr.1565-0 ne sipërfaqe prej 5227m², ngastren nr.1572-0 ne sipërfaqe prej 4645m², ne ngastren nr.1550-0 ne sipërfaqe prej 1148m², ngastren nr.1549-0 ne sipërfaqe prej 1168m², te gjitha keto ngastra gjenden ne vendin e qujtur “Rajac Ristina” ZK.Viti, baza e kerkese padise per vertetimin e gjendjes faktike është e bazuar në institutin e mbajtjes me posedim dhe mirbesim mbi 20 vite e me teper qe e ka parapar ligji i vjeter i pronesise dhe ligji i sotem aktual.

Përfaqësuesi i përkohshëm i të paditureve, në përgjigje në padi ka kundërshtuar ne teresi kerkesepadine e paditesit sepse padia eshte e paargumentuar dhe e pa mbeshtetur ne prova konkrete, ndërsa në seancën, përgaditore, atë kryesore dhe në fjalën përfundimtare kishte theksuar se pas administrimit te provave, degjimin e deshmitareve i mbetet gjykates qe ne pajtim me ligjin dhe provave te adminstruara te vendos sipas bindjes se saj. Nuk i ka kundërshtuar propozimet për administrimin e provave materiale, nuk ka pasur vërejtje në asnjë provë materiale e as deklaratat e dëshmitarëve.

Provat e administruara në shqyrtimin kryesor

Për të vërtetuar në mënyrë të drejtë dhe të plotë pretendimet e palëve ndërgjyqëse si dhe për të vërtetuar drejtë gjendjen faktike, gjykata i ka administruar dhe vlerësuar këto prova: certifikaten pronësore me nr.1285/2024 e dt.26.08.2024. ne emer te Ramadan Ramadani-Rasim, kopjen e planit me nr.1285/2024, e dt.26.08.2024, certifikata pronësore me nr.1284/2024 e dt.26.08.2024. ne emer te Andrejeviq Dejko-Joze, kopjen e planit me nr.1284/2024, e dt.26.08.2024, certifikaten pronësore me nr.1284/2024 e dt.26.08.2024. ne emer te Andrejeviq Dejko-Joze, certifikata me nr.1284/2024 e dt.26.08.2024. ne emer te Sokoloviq Petar (Lubomir), kopjen e planit me nr.1284/2024, e dt.26.08.2024, certifikata pronësore me nr.1298/2024 e dt.27.08.2024. ne emer te Selimi Rrahim (Deli), kopjen e planit me nr.1298/2024, e dt.27.08.2024, certifikata me nr.1298/2024 e dt.27.08.2024. në emer të Selimi Metush (Deli), kopjen e planit me nr.1298/2024, e dt.27.08.2024, ekstrakti nga regjistri qendror i gjendjes civile me nr.E28223643 ne emer te paditurit Enver Ramadani, (djali i Ramadan Ramadani), certifikata e vdekjes me nr.serik V10710232 ne emer te Ramadan Ramadani- i vdekur, ekstrakti nga regjistri qendron i gjendjes civile me nr.serik E-28207149 ne emer te S.S.i paditur, certifikata e vdekjes me nr.serik V19708442 ne emer te Rrahim Selimi- i vdekur, ekstrakti nga regjistri qendron i gjendjes civile me nr.serik E-27612415 ne emer te R.D. i paditur, certifikata e vdekjes me nr.serik V10645518 ne emer te Metush Deliji- i vdekur,përgjegjeja e policise e dt.16.08.2024, pergjegjeja e agjensionit Kosovar per krahasim dhe verifikim te prones menr.01125/24/vd e dt.07.08.2024, ekspertizat e ekspertit gjeodet Valton Syla te dt. 21.10.2024 dhe ka dëgjuar dëshmitarët Nezir Sallahu dhe Haqif Hasani qe te dy nga f. K..K.Viti.

Seanca e vendshiqimit

Më date 21.10.2024, gjykata e ka mbajtur seancën e vend-shikimit, në të cilën kanë prezantuar paditësi, përfaqësuesi i paditësit, përfaqësuesi i përkohshëm i të paditures Av. Shpëtim Bislimi dhe eksperti gjeodet Valton Syla. Me qëllim të identifikimit të nagstarve kadastrale 01574-0, 01607-0, 01563-0, 1565-0, 1572-0, 01550-0 dhe 1549-0, ngastrat për nga gjatesia shtrihen në veri-jug, ndërsa nga gjersia lindje perendim, ngastrat kan qen të mbjelluar me kultur miser, ndersa ngastar me numer 1565-0 ka qen e mbejllur me kultur gruri. Përfaqësuesi i përkohshëm nuk ka pasur vërejtje.

Konstatimi i ekspertit gjeodet

Në konstatimin e tij, eksperti gjeodet¹, ka gjetur :se parcela kadastrale nr.1574-0 e cila ndodhet në vendin e quajtur “Rajac Ristina”, me kulture bujqësore arë e klasës së 3, sipas regjistrit kadastral të DGJKP-së në Viti, evidentohet në emër të Dejko Andrejeviq (Joze) dhe ka sipërfaqe prej 1142 m2, e cila parcelë në vendngjarje në anën veriore kufizohet me parcelën me numër 1363-0, e cila evidentohet në emër të Vitomir Cigullajkiq, R.Denkiq Piriq, në anën lindore kufizohet me parcelën nr.1571-0, cila evidentohet në emër të Borka Ignjatoviq, ne anen jugore kufizohet me parcelen nr.1573-0 cila evidentohet në emër të Xhelal Musa dhe me parcelën numër 3615-0, cila evidentohet në emër të Komuna e Vitisë-Rrugët, ne anen perendimore kufizohet me parcelen nr.1575-0 cila evidentohet në emër të Zhivojin Dajiq dhe me parcelën numër 1562-0 cila evidentohet në emër të Nedeljko Peperoviq, aktualisht është me shfrytëzim e mbjellur miser (korrur).

Parcela kadastrale nr.1607-0 e cila ndodhet në vendin e quajtur “Rajac Ristina”, me kulture bujqësore arë e klasës së 3, sipas regjistrit kadastral të DGJKP-së në Viti, evidentohet në emër të Dejko Andrejeviq (Joze) dhe ka sipërfaqe prej 280m2, e cila parcelë në vendngjarje në anën veriore kufizohet me parcelën me numër 3615-0, cila evidentohet në emër të Komuna e Vitisë-Rrugët, në anën lindore kufizohet me parcelën nr.1606-0, cila evidentohet në emër të Xhelal Musa, ne anen jugore kufizohet me parcelen nr.1605-0 cila evidentohet në emër të Zaim Qerimi, dhe me parcelën numër 1604-0, cila evidentohet në emër të Stanimir Katanqeviq, Z.Borka Paloqeviq dhe Z.Milevka Kojiq, ne anen perendimore kufizohet me parcelen nr.1608-0, cila evidentohet në emër të Zhivojin Dajiq, aktualisht është me shfrytëzim e mbjellur miser (Korrur).

Parcela kadastrale nr.1563-0 e cila ndodhet në vendin e quajtur “Rajac Ristina”, me kulture bujqësore arë e klasës së 3, sipas regjistrit kadastral të DGJKP-së në Viti, evidentohet në emër të Petar Sokoloviq (Ljubomir) dhe ka sipërfaqe prej 1703m2, e cila parcelë në vendngjarje në anën veriore kufizohet me parcelën me numër 1363-0, e cila evidentohet në emër të Vitomir Cigullajkiq, R.Denkiq Piriq, në anën lindore kufizohet me parcelën nr.1571-0, cila evidentohet në emër të Borka Ignjatoviq, ne anen jugore kufizohet me parcelen nr.1573-0 cila evidentohet në emër të Xhelal Musa dhe me parcelën numër 3615-0, cila evidentohet në emër të Komuna e Vitisë-Rrugët, ne anen perendimore kufizohet me parcelen nr.1575-0 cila evidentohet në **emër të Zhivojin Dajiq** dhe me parcelën numër 1562-0 cila evidentohet në emër të Nedeljko Peperoviq, aktualisht është me shfrytëzim e mbjellur miser (korrur).

Parcela kadastrale nr.1565-0 e cila ndodhet në vendin e quajtur “Rajac Pljozh”, me kulture bujqësore arë e klasës së 3, sipas regjistrit kadastral të DGJKP-së në Viti, evidentohet në emër të Ramadan Ramadani (Rasim) dhe ka sipërfaqe prej 5227m2, e cila parcelë në vendngjarje në anën veriore kufizohet me parcelën me numër 1363-0, e cila evidentohet në emër të Vitomir Cigullajkiq, R.Deniq Piriq, në anën lindore kufizohet me parcelën nr.1358-1 e cila evidentohet në emër të

Marko Saviq me parcelën 1566-0, e cila evidentohet në emër të Ahmet Ahmeti, me parcelën 1567-0 e cila evidentohet në emër të Mileva Nikoliq, ne anen jugore kufizohet me parcelen nr.1569-0, e cila evidentohet në emër të Milosava Vidiq, ne anen perendimore kufizohet me parcelen nr.1564-0 dhe me parcelën numër 1570-0, e cila evidentohen në emër të Toma Andrejeviq, aktualisht është me shfrytëzim e mbjellur grur.

Parcela kadastrale nr.1572-0 e cila ndodhet në vendin e quajtur “Rajac Ristina”, me kulture bujqësore arë e klasës së 3, sipas regjistrit kadastral të DGJKP-së në Viti, evidentohet në emër të Ramadan Ramadani (Rasim) dhe ka sipërfaqe prej 4645m2, e cila parcelë në vendngjarje në anën veriore kufizohet me parcelën me numër 1363-0, e cila evidentohet në emër të Vitomir Cigullajkiq, R.Denkiq Piriq, në anën lindore kufizohet me parcelën nr.1571-0, cila evidentohet në emër të Borka Ignjatoviq, ne anen jugore kufizohet me parcelen nr.1573-0 cila evidentohet në emër të Xhelal Musa dhe me parcelën numër 3615-0, cila evidentohet në emër të Komuna e Vitisë-Rrugët, ne anen

perendimore kufizohet me parcelen nr.1575-0 cila evidentohet në emër të Zhivojin Dajiq dhe me parcelën numër 1562-0 cila evidentohet në emër të Nedeljko Peperoviq, aktualisht është me shfrytëzim e mbjellur miser (korrur).

Parcela kadastrale nr.1549-0 e cila ndodhet në vendin e quajtur “Rajac Pljozh”, me kulture bujqësore arë e klasës së 2, sipas regjistrit kadastral të DGJKP-së në Viti, evidentohet në emër të M.S.dhe ka sipërfaqe prej 1168m², e cila parcelë në vendngjarje në anën veriore kufizohet me parcelën me numër 1384-0, e cila evidentohet në emër të Zina Gashi, dhe me parcelën 1383-0, 1382-0, të cilat evidentohen në emër të Gëzim Zenuni, me parcelën 1381-1 e cila evidentohet në emër të Sroblojub Kalinci, në anën lindore kufizohet me parcelën nr.3615-0, e cila evidentohet në emër të Komuna e Vitisë-Rrugë, ne anen jugore kufizohet me parcelen nr.1551-0, e cila evidentohet në emër të Fehmi Deliu, ne anen perendimore kufizohet me parcelen nr..3607-0 e cila evidentohet në emër të P.SH.Ujerat, aktualisht është me shfrytëzim e mbjellur miser(korrur).

Parcela kadastrale nr.1550-0 e cila ndodhet në vendin e quajtur “Rajac ”, me kulture bujqësore arë e klasës së 2, sipas regjistrit kadastral të DGJKP-së në Viti, evidentohet në emër të Rrahim Selimi (Deli) dhe ka sipërfaqe prej 1148m², e cila parcelë në vendngjarje në anën veriore kufizohet me parcelën me numër 1384-0, e cila evidentohet në emër të Zina Gashi, dhe me parcelën 1383-0, 1382-0, të cilat evidentohen në emër të Gëzim Zenuni, me parcelën 1381-1 e cila evidentohet në emër të Sroblojub Kalinci, në anën lindore kufizohet me parcelën nr.3615-0, e cila evidentohet në emër të Komuna e Vitisë-Rrugë, ne anen jugore kufizohet me parcelen nr.1551-0, e cila evidentohet në emër të Fehmi Deliu, ne anen perendimore kufizohet me parcelen nr..3607-0 e cila evidentohet në emër të P.SH.Ujerat, aktualisht është me shfrytëzim e mbjellur miser(korrur).

Përmbledhje e deklaratave të dëshmitarëve

Dëshmitari Nezir Sallahu , i moshës 75 vjeçare, në seancën e shqyrtimit kryesor, ndër të tjera, ka deklaruar : se është e vërtete se paditesit N.Q.i ka blere tri ngastra te cilat gjinden ne fushe te Vitise, për te afuar me afersishte vendi quhet “te lisi” e din se keto ngastra jan blere në vitin 1982-1985, qate kohe i kishte blere nga qytetaret e nacionalistetit serb, prezente nuk ka qen kur ishin blere këto ngastra mirpo, me paditesin kishin qen afer me shtepia, dhe po qe se dikush nje lope e kishte blere kishin shkuar dhe ja kishin bërë perhajre, keshtu që edhe për kto ngastra kishin qen dhe ja kishin bërë perhajre dhe ishin informuar, keto ngastra i ka paguar në teresi me dinar jugosllave pasi qe i njejt ne ate kohe ishte ne qarkullim. Nuk ka ndegjuar që të jete ankuar ndonji qytetar te nacionalitet serbe apo nacionaliteve tjera lidhur me keton ngastra. Paditesi qe nga koha e blerejes ka hyre ne posedim dhe shfrytezim te ketyre ngastrave ku disa here i ka edhe lavruar keto ngastra, me tej shton se paditesi nuk eshte penguar nga askush per shfrytezimin e ketyre ngastrave.

Dëshmitari Haqif Hasani , i moshes 71 vjeçare, në seancën e shqyrtimit kryesor, ndër të tjera, ka deklaruar e di se paditesi N.Q.i ka blere nja 3 ngastra ne vitin 1982-1985 nga se saksishte nuk mundet me i mbajt mend se ka kaluar nje kohe e gjate, i ka blere nga disa qytetar te nacionalitetit serb, te cilet kishin qen bashkfshatar e tyre të fshatit K., dhe i kishte paguar ne teresi, prezente nuk kishte qen kur ishte bërë kjo shitblerje por ka ndegjuar nga njerzit se i kishin blere keto ngastra dhe kishte qen për të ja bërë perhajre dhe shume here I kishte punuar keto ngastra. Keto ngastra paditesi i ka punuar qe nga koha e shitblerjes dhe shumicen e rasteve keto ngastra kan qen te mbjellur me misër apo grur. Me tej shton se nuk ka ndegjuar se asnjher te jete ankuar ndonji qytetar i nacionalistetit serbe apo te nacionalitetit tjetet, nuk është i sigurte se me qfare valutet ishte bere pagesa , por nga se ne ate kohe ishte qarkullimim valuta dinar jugosllave, dhe pagesa mendon se ishte bere me dinar jugosllave, paditesi nuk është penguar nga askush për shfrytezimin e ketyre ngastrave.

Provat materiale

Sipas certifikatës me numër certifikaten pronësore me nr.1285/2024 e dt.26.08.2024. ne emer te Ramadan Ramadani-Rasim, kopjen e planit me nr.1285/2024, e dt.26.08.2024, gjykata vërtetoi se ngastra me numër 1565-0 në vendin e quajtur “ Rajact Pljozh” me sipërfaqe prej 5227 m², dhe ngastra me numër 01572-0, në vendin e quajtur “ Rajact Ristina” me sipërfaqe prej 4645 m², ZK Viti, evidentohet në emër të Ramadan Ramadani (Rasim).

Sipas certifikatës me numër certifikaten pronësore me nr.1284/2024 e dt.26.08.2024. ne emer te Andrejeviq Dejko-Joze, kopjen e planit me nr.1284/2024, e dt.26.08.2024, gjykata vërtetoi ngastren me numër 1574-0,në vendin e quajtur “ Rajact Ristina” me sipërfaqe prej 1142 m2 ZK Viti, evidentohet në emër të Andrejeviq Dejko (Joze).

Sipas certifikatës me numër certifikaten pronësore me nr.1284/2024 e dt.26.08.2024. ne emer te Andrejeviq Dejko-Joze, kopjen e planit me nr.1284/2024, e dt.26.08.2024, gjykata vërtetoi se ngastra me numër 1607-0, në vendin e quajtur “ Rajact Ristina” me sipërfaqe prej 280 m2 ZK Viti, evidentohet në emër të Andrejeviq Dejko (Joze).

Sipas certifikatës me numër certifikaten pronësore nr.1284/2024 e dt.26.08.2024. kopjen e planit me nr.1284/2024, e dt.26.08.2024 , gjykata vërtetoi se ngastra me numër 1563-0,në vendin e quajtur “ Rajact Ristina” me sipërfaqe prej 1703 m2 ZK Viti, evidentohet ne emer te Sokoloviq Petar (Lubomir),

Sipas certifikatës me numër certifikaten pronësore me nr.1298/2024 e dt.27.08.2024 dhe kopjen e planit me nr.1298/2024, e dt.27.08.2024, gjykata vërtetoi se ngastra me numër 1550-0, në vendin e quajtur “ Rajact” me sipërfaqe prej 1148 m2 ZK Viti, evidentohet ne emer te Selimi Rrahim (Deli).

Sipas certifikatës me numër certifikaten pronësore me nr.1298/2024 e dt.27.08.2024 dhe kopjen e planit me nr.1298/2024, e dt.27.08.2024. gjykata vërtetoi, se ngastra me numër 1549-0 në vendin e quajtur “ Rajact Pljozh” me sipërfaqe prej 1168 m2 ZK Viti, evidentohet ne emer të Selimi Metush (Deli) .

Nga ekstrakti i regjistrimit qendror i gjendjes civile me nr.E28223643 ne emer te paditurit Enver Ramadani, gjykata konstaton se i paditur E.R.është djali i Ramadan Ramadani,

Nga certifikata e vdekjes me nr.serik V10710232 gjykata konstatoi se Ramadan Ramadani, nga babi Rasim dhe nëne Hava ka vdekur, me datën 28.02.2006, në Prishtinë.

Nga ekstrakti i regjistrimit qendron i gjendjes civile me nr.serik E-28207149 ne emer te S.S. gjykata konstaton se S.S., është djali i Raim Selimit.

Nga certifikata e vdekjes me nr.serik V19708442 gjykata vërtetoi se Rahim Selimi nga babi Delija Selimi dhe nëna Amide Selimi ka vdekur em datën 11.05.1978, në fshatin K..

Nga ekstrakti i regjistrimit qendron i gjendjes civile me nr.serik E-27612415 ne emer te R.D. i paditur, gjykata konstaton se R.D. është i lindur me daten 21.03.1965, në fshatin K., Komuna e Vitisë, nga babi Vebi Delija dhe nena Fatime Delija .

Nga certifikata e vdekjes me nr.serik V10645518, gjykata konstaton se Metush Deliji- ka vdekur me datën 01.02.1962 në fshatin K., Komuna e Vitisë.

Sipas përgjigjes së Stacionit policor në Viti datës16.08.2024, gjykata është informuar se të paditurit A.D.ish nga fshati K., K.Viti , S.L. ish nga fshati K., K.Viti , nuk jetonë në K., por të njëjti jetojnë në shtetin e Serbisë dhe se nuk i dihet adresa e saktë.

Sipas përgjigjes nga AKKVP, me nr.ref., me numër 01125/24/vd e dt.07.08.2024, gjykata është informuar se për ngastrat kontestuese, asnjë person, qoftë fizik apo juridik, nuk ka paraqitur asnjë kërkesë, ankesë apo çfarë do pretendimi tjetër pasuror- pronësor lidhur me keto ngastra.

Gjendja faktike e vërtetuar

Nga administrimi i provave materiale, gjykata ka vërtetuar se paditësi është në posedim të papenguar të ngastrës kadastrale është pronar i ngastrës me numër 01574-0, në vendin e quajtur “ Rajc Ristina ”, me sipërfaqe prej 1142m², ZK Viti, e cila tek DGJKP në Viti është e regjistruar sipas certifikatës me numër të lëndës 1284/2024 në emrin e A.D.ish nga K.i, është pronar i ngastrës me numër 01607-0, në vendin e quajtur “ Rajc Ristina ”, me sipërfaqe prej 280m², ZK Viti, e cila tek DGJKP në Viti është e regjistruar sipas certifikatës me numër të lëndës 1284/2024 në emrin e A.D.ish nga K.i, është pronar i ngastrës me numër 01563-0, në vendin e quajtur “ Rajc Ristina ”, me sipërfaqe prej 1703m², ZK Viti, e cila tek DGJKP në Viti është e regjistruar sipas certifikatës me numër të lëndës 1284/2024 në emrin e Sokoloviq Petar(Ljubomir) ish nga K.i, është pronar i ngastrave kadastrale me numer 01565-0 në sipërfaqe të përgjithshme prej 5227 m2 dhe ngastres 01572-0, në sipërfaqe të përgjithshme prej 4645 m2, të cila gjendet në vendin e quajtur “ Rajc Ristina” ZK – Viti, të cilat tek DGJKP në Viti janë të regjistruara sipas certifikatës me numër të lëndës 1285/2024 në emrin e të ndjerit Ramadan (Rasim) Ramadani ish nga fshati K., K.Viti, është pronar i ngastres kadastrale me numer 01550-0 në sipërfaqe të përgjithshme prej 1148 m2, e cila gjendet në vendin e quajtur “ Rajac” ZK – Viti, e cilat tek DGJKP në Viti është e regjistruar sipas certifikatës me numër të lëndës 1298/2024 në emrin e të ndjerit Rrahim (Deli) Selimi ish nga fshati K., K.Viti, është pronar i ngastres kadastrale me numer 01549-0 në sipërfaqe të përgjithshme prej 1168 m2, e cila gjendet në vendin e quajtur “ Rajac pljozh” ZK – Viti, e cilat tek DGJKP në Viti është e regjistruar sipas certifikatës me numër të lëndës 1298/2024 në emrin e të ndjerit Metush Selimi (Deli), ish nga fshati K., K.Viti.

Paditësi, i kishte blerë ngastrat kadastrale, në vitin 1980, 1982,1985 dhe 1987 nga të paditurit. Faktin krijimit të raportit juridik ndërmjet paditësit me të paditurit, gjykata e vërtetoi deklarat e paditësit dhe provata tjera material, kurse faktin e posedimit të pandërprerë gjykata e vërtetoi nga deklaratat e dëshmitarëve, Nezir Sallahu dhe Haqif Hasani, të dhënë në seancën e shqyrtimit kryesor më datën 28.10.2024.

Pas administrimit të provave dhe vlerësimit të pretendimeve të palëve ndërgjyqëse, e duke u mbështetur në nenin 8 të LPK-së, gjykata erdhi në përfundim se kërkesë padia e paditësit është e bazuar, andaj edhe ka vendosur si në dispozitiv të aktgjyqimit.

Baza ligjore dhe vlerësimi përfundimtar i gjykatës

Pasi gjykata e ka vërtetuar gjendjen faktike si më lart, si ligj material aplikoi Ligjin mbi Themelimin e Marrëdhënieve Juridike Pronësore të vitit 1980 (tutje LMTHJP), përkatësisht në nenin 28 të tij, sipas së cilit është përcaktuar: “Mbajtësi me mirëbesim i sendit të paluajtshëm, mbi të cilin tjetri ka të drejtën e pronësisë, fiton të drejtën e pronësisë mbi këtë send me parashkrimin fitues me kalimin e kohës prej 20 vjetësh” ndërsa, neni 70 ka përcaktuar: “Posedimin e sendit e ka çdo person që ushtron drejtpërdrejt zotërimin faktik të sendit (posedimi i drejtpërdrejtë)” tutje, neni 72 ka përcaktuar: “Posedimi është i ligjshëm poqëse mbështetet në bazën e plotfuqishme juridike që nevojitet për të fituar të drejtën e pronësisë dhe nëse nuk është fituar me forcë, me mashtrim ose me keqpërdorimin e besimit. Posedimi është me mirëbesim poqëse mbajtësi nuk di ose nuk mund të dijë se sendi që e mban nuk është i tij. Mirëbesueshmëria e posedimit supozohet”.

Të gjitha provave materiale, gjykata ua fali besimin në tërësi pasi ishin në harmoni njëra-tjetrën, me të cilat u vërtetuan të gjitha pretendimet e paditësit rreth faktit të krijimit të raportit juridik me të padituit, pagesës së çmimit të kontraktuar, posedimit të vazhdueshëm dhe të pandërprerë për më shumë se 30 vjet. Po ashtu, gjykata ua fali besimin deklaratave të dëshmitarëve të dëgjuar, pasi ishin në harmoni me njëra-tjetrën, me pretendimet si në padi dhe provat e tjera të administruara në këtë

çështje kontestimore. Dëshmitarët, faktet lidhur me këtë çështje i kishin të njohura personalisht, pasi ishin dëshmitarë të moshuar – mbi 71 vjeç secili, dhe i konfirmuan pretendimet e paditësit se ngastrat që janë objekt i kontestit, paditësi i ka blerë, ka hyrë në posedim dhe për më shumë se 30 vjet i ka në posedim të papenguar.

Gjykata ka vlerësuar edhe theksimet dhe provat e tjera të palëve ndërgjyqëse, por ka gjetur se të njëjtat janë pa ndikim në nxjerrjen e këtij aktgjykimi, për çka edhe nuk e pa të arsyeshme që të njëjtat t'i elaboroi posaqërish.,

Vendimi për shpenzimet procedurale

Për shpenzimet e procedurës, gjykata vendosi duke u mbështetur në nenin 452.4 të LPK-së. shpenzimet e procedurës i barti paditësi.

Gjykata duke u bazuar në nenin 261 të LPK-së sa i përket tërheqjes së padisë së paditësit për të paditurin si në dispozitiv të këtij aktgjykimi, ngase në dispozitivin përkatës është i mundur një veprim i tillë procedural, respektivisht në nenin 261 të LPK-së shprehimisht është përcaktuar se „*Paditësi mund ta tërheqë padinë pa pëlqimin e të paditurit deri në momentin në të cilin i padituri e paraqet në gjykatë përgjigjen në padi. Padia mund të tërhiqet edhe më vonë, deri në përfundimin e shqyrtimit kryesor, në qoftë se i padituri e jep pëlqimin për një gjë të tillë. Po që se i padituri brenda shtatë (7) ditësh nga dita e njoftimit për tërheqjen e padisë nuk deklarohet për këtë gjë, do të konsiderohet se e ka dhënë pëlqimin për tërheqjen e padisë.*

Nga të lartcekurat, e duke u bazuar në nenin 2 lidhur me nenin 142 të LPK-së, gjykata vendosi si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

**GJYKATA THEMELORE GJILAN - DEGA E GJYKATËS VITI
DEPARTAMENTI I PËRGJITHSHËM – DIVIZIONI CIVIL
C.nr.600/2019, dt.31.10.2024**

**Gjyqtari,
Nexhat Aliu**

Këshilla Juridike: Kundër pikës I të dispozitivit të aktgjykimit, është e lejuar ankesa në Gjykatën e Apelit, në afat prej 15 ditëve nga dita e pranimit të aktgjykimit. Ankesa në kopje të mjaftueshme, dorëzohet nëpërmjet kësaj gjykatë.

Kundër pikës V të dispozitivit nuk është e lejuar ankesa.